TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. I/12
Dt. 28.02.2020
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

trainkos

**Hekurudhat e Kosovës**

# RAPORT VJETOR 2019

Vendimi: Nr. I/12

Bordi i Drejtorëve i HK "Trainkos" Sh.a njëzëri miratoi Raportin Vjetor për vitin 2019 në mbledhjen Nr.11 të mbajtur më datë 28.02.2020

| | Delegoi | Aprovoi |
|---|---|---|
| **Emri Mbiemri:** | **Gelor Shala**<br>**Kryeshef Ekzekutiv** | **Ramush Ahmetaj**<br>**Kryesuesi i BD** |
| **Nënshkrimi:** | | |
| **Data:** | **14.02.2020** | **28.02.2020** |

TRAINKOS SH.A. Fushë Kosovë · TRAINKOS D.D. Kosovo Polje · TRAINKOS J.S.C. Fushë Kosovë 3

trainkos

**Hekurudhat e Kosovës**

# RAPORT VJETOR 2019



**Fushë Kosovë,**

**Shkurt 2020**

# PËRMBAJTJA


| | | |
|---|---|---|
| I. | HYRJE | 3 |
| II. | RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE | 4 |
| II. 1 | Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes | 5 |
| II. 2 | Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenten | 8 |
| II. 3 | Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë | 9 |
| II. 4 | Komitetet e Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.a | 10 |
| III. | FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV | 11 |
| III. 1 | Ngjarjet kryesore të vitit | 13 |
| IV. | PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE | 14 |
| IV. 1 | Transporti i Mallrave | 14 |
| IV. 2 | Transporti i Udhëtarëve | 17 |
| IV. 3 | Zyra e Mirëmbajtjës së Mjeteve Lëvizëse | 20 |
| V. | PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET | 23 |
| V. 1. | Gjendja financiare | 23 |
| V.1.1 | Të hyrat | 23 |
| V.1.2 | Shpenzimet | 24 |
| | Tabela 1. Të hyrat dhe Shpenzimet Operative | 24 |
| V. 2 | Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas Bankës (31.12.2019) | 26 |
| V. 3 | Bilanci i gjendjes | 27 |
| VI. | PROJEKTET KAPITALE | 28 |
| VII. | ZHVILLIMI I BIZNESIT | 30 |
| VII.1 | Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit | 30 |
| VII.2 | Koordinimi i proceseve me ARH-në dhe Institucionet tjera | 31 |
| VII.3 | Aktivitetet e Marketingut | 32 |
| VII.4 | Raportimi i rregullt vjetor në Asociacionet tjera Hekurudhore | 32 |
| VII.5 | Sfidat dhe rreziqet e të ardhmes së korporatës | 33 |
| VIII | STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH.A | 34 |
| IX | ZYRA LIGJORE | 37 |
| IX.1 | Kontestet gjygjësore | 36 |
| IX. 2 | Rreziqet nga kontestet gjygjësore për vitin 2020 | 37 |
| X. | TRANSAKSIONET E REALIZUARA | 38 |
| XI. | PËRFUNDIM | 39 |

**I. ANEKS RAPORTI**

- Raport lidhur me sponsorimet dhe donacionet
- Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2019
- Raporti i vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve

# I. HYRJE

Gjatë gjithë vitit 2019, kompania kishte një ecuri progresive drejt realizimit të planit operativ dhe financiar. Megjithatë, ndërmarrja edhe gjatë këtij viti është ballafaquar me sfida të shumta dhe të ndryshme, sepse sikurse viteve të kaluara çështja e mbulimit të shpenzimeve të transportit të udhëtarëve nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës vazhdon të mbetet e pa zgjidhur në tërësi. Mirëpo falë angazhimit të palodhshëm të tërë ekipit të HK - Trainkos Sh. A. është arritur që ndërmarrja të ruaj likuiditetin e saj.

Në kuadër të këtij raporti do të përfshihen aktivitetet dhe ngjarjet më të rëndësishme të ndërmarrjes të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2019. Raporti është ndërtuar sipas kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të Aksionarit si dhe përmban edhe disa pjesë tjera të rëndësishme që e pasurojnë edhe më shumë këtë raport.

Në fillim të raportit është prezantuar fjala e kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, ku është theksuar performanca e kompanisë bashkë me disa prej aktiviteteve të saj. Raporti i Kryesuesit ofron informacione edhe në lidhje me kapitalin e kompanisë, politikat që ndikojnë në zhvillimin e biznesit si dhe të dhënat tjera për strukturën dhe angazhimet e Bordit.

Në vazhdim pasqyrohet raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, duke ofruar të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhënat për performancën operative e financiare dhe progresin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit. Në këtë pjesë raporti ofron të dhëna të detajuara për shpenzimet, investimet kapitale të kompanisë dhe gjithashtu një elaborim të perspektivës bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese. Po ashtu brenda raportit është paraqitur edhe skema organizative e stafit të kompanisë, ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe si dhe një pjesë e raportit i është kushtuar çështjeve të ndryshme të lidhura me kontestet gjyqësore. Për të qenë raporti sa më i qartë dhe i kompletuar, brenda tij janë përfshirë edhe grafikone, tabela statistikore dhe skema tjera me sqarime të nevojshme.

Raporti Vjetor 2019 i HK - Trainkos Sh.A. ka të bashkëngjitur edhe shtojcën apo Aneksin 1, i cili përmban të dhëna tjera shtesë të cilat mbesin për përdorim të Aksionarit. Në këtë pjesë janë përfshirë raporti lidhur me sponsorimet dhe donacionet, Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2019 dhe Raporti i Vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve.

# II. RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

**Të nderuar aksionarë,**

Nga fillimi i muajit prill 2019 është emëruar Bordi i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A. Që nga kjo periudhë Bordi është angazhuar me përkushtim të lartë që ndërmarrja të ketë kontinuitet të punëve në arritjen e rezultateve në raport me objektivat e planifikuara.

Përmbushja e obligimeve dhe përgjegjësive ligjore ka qenë fokusi kryesor i Bordit. Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare (Nr. 06/L-016), Bordi i Drejtorëve i Trainkos Sh.A, në emër të aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin edhe nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të. Hartimi i politikave dhe dokumenteve tjera strategjike për kompaninë si dhe mbikëqyrja e vazhdueshme në zbatimin e tyre ka qenë fokusi kryesor i BD për një qeverisje korporative të ndërmarrjes.

Në saje të angazhimit të të gjithë drejtorëve të bordit nuk kanë munguar as sukseset në përmbushjen e obligimeve. Po ashtu edhe angazhimi i stafit menaxhues si dhe drejtorëve të Bordit që kanë vepruar deri në emërimin e Bordit aktual është për t'u vlerësuar.

Në vijim, në këtë raport-vështrim do të paraqesim të dhënat mbi aktivitetet, performancën e ndërmarrjes dhe të dhëna tjera të rëndësishme për vitin 2019.

## II. 1. AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES

Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes gjatë vitit 2019 kanë qenë në drejtim të realizimit të objektivave të planifikuara për vitin 2019 si dhe në drejtim të tejkalimit të pengesave dhe vështirësive tjera të ndërmarrjes.

Ndër sfidat e para, me të cilat u ballafaquam qysh në fillim të punës sonë, ishte çështja mbulimit të shpenzimeve në transportin e udhëtarëve, përkatësisht mungesa e mjeteve për këtë qëllim. Borxhet e akumuluara ndër vite nga transporti i udhëtarëve, gjithashtu ishte shqetësuese. Falë punës dhe angazhimit të përbashkët Bord-Menaxhment dhe mbështetjes nga ana e Aksionarit, borxhet e akumuluara ndaj Infrakos, përkatësisht obligimet e qasjes në rrjet nga transporti i udhëtarëve, është arritur që dukshëm të zvogëlohen. Sa i përket transportit të udhëtarëve, përveç çështjes së mbulimit të shpenzimeve, në fokusin tonë ka qenë edhe ngritja e performancës në këtë kategori shërbimesh pas një trendi të vazhdueshëm të rënies të numrit të udhëtarëve. Këto çështje do të jenë sfiduese edhe në të ardhmen dhe paraqesin njërin prej shkaqeve më ndikuese në performancën dhe zhvillimin e ndërmarrjes.

Gjithashtu, aktivitetet dhe angazhimet tjera, gjatë gjithë punës tonë, kanë qenë edhe në drejtim të eliminimit të të gjeturave nga auditimi i vitit paraprak dhe gjithashtu edhe në hartimin e dokumenteve strategjike e rregulloreve tjera, mbi bazën e të cilave zhvillohet aktiviteti i ndërmarrjes të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A.

- **Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2019**

Përkushtimi kryesor i Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2019 ka qenë arritja e caqeve të përcaktuara në Planin e Biznesit për këtë vit. Për shkak të gjendjes në ndërmarrje, mos mbulimi i tërsishëm i shpenzimeve në transportin e udhëtarëve dhe për shkak të mos realizimit të planeve në transportin e mallërave, ndërrmarrja ka bërë Rishikimin e Planit të Biznesit 2019.

Në saje të angazhimit të përbashkët të Bordit dhe të stafit të kompanisë, kemi arritur që objektivat e përcaktuara t'i përmbushim në pjesën më të madh të tyre.

Hartimi i politikave të kompanisë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2019. Janë nxjerrë një serë rregulloresh të cilat definojnë procedura e çështje të brendshme të organizimit të punëve.

Bashkëpunimi me institucionet vendore e ndërkombëtare gjithashtu ka qenë në fokus të angazhimit tonë dhe nuk kanë munguar përpjekjet tona në këtë drejtim.

- **Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual**

Gjatë vitit 2019 Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. kanë pasur një rezultat jo shumë të kënaqshëm operativ e financiar. Përderisa relizimi operativ e financiar ka shënuar rritje në

krahasim me vitin paraprak, në aspektin e planifikimit për vitin 2019 objektivat nuk janë arritur plotësisht.

Sa i përket realizimit operativ e financiar në transportin e udhëtarëve poashtu është shënuar një rritje e vogël krahasuar me vitin 2018, ndërsa në raport me planifikimin për vitin 2019 objektivat nuk janë arritur plotësisht.

- **Transporti i Mallrave**

Performanca operative në transportin e mallrave, sikurse është e pasqyruar edhe në pjesën tabelare por edhe përshkruese të këtij raporti, është për 20 % neto tonë mallra të transportuara më pak se sa planifikimi, apo për 82 % më shumë se sa realizimi gjatë vitit 2018.

Performanca financiare nga transporti i mallrave është për 27 % më pak se sa planifikimi vjetor 2019, ndërsa krahasuar me vitin paraprak është më shumë për 71 %.

- **Transporti i Udhëtarëve**

Performanca operative në numrin e udhëtarëve është për 1.56 % më shumë në krahasim me vitin paraprak si dhe për –33.16 % më pak se sa planifikimi për vitin 2019.

Sa i përket realizimit financiar në transportin e udhëtarëve nga shitja e biletave, përkatësisht të të hyrat nga kjo kategori kanë qenë 7.15 % më shumë krahasuar me 2018, ndërsa krahasuar me planifikim për vitin 2019 të hyrat kanë qenë prej – 30.41 % më pak.

- **Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes**

Një ndër sfidat kryesore për kompaninë Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. A. mbetet modernizimi i parkut të mjeteve lëvizëse duke pasur parasysh numrin e vogël të këtyre mjeteve që kemi në dispozicion por edhe vjetërsinë e tyre të cilat përveç shpenzimeve të larta për mirëmbajtje kanë edhe shpenzime tjera operuese të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e kostos se përgjithshme.

Vlen të theksohet se kjo gjendje e mjeteve lëvizëse që kemi në parkun tonë është si rezultat i buxhetit të vogël të ndarë nga ana Qeverisë së Republikës së Kosovës për Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. Mjetet e ndara për projektet kapitale në vitin 2019 janë shfrytëzuar në disa projekte, por, megjithatë gjendja ende nuk është e kënaqshme sa i përket mjeteve lëvizëse.

Fillimi i investimeve në modernizimin e rrjetit hekurudhor është shumë më rëndësi për zhvillimin hekurudhor, por nga kjo kërkohet që investimet të shtohen edhe në modernizimin e mjeteve lëvizëse të HK-Trainkos Sh.A

Po ashtu, sfidë e vazhdueshme mbetet përpilimi dhe hartimi i politikave strategjike për zhvillim të kompanisë. Në këtë kontekst, BD është i përkushtuar të ndërmarrë nismat që janë

në përgjegjësi të tij, që projekteve paraprake t'u japë shtytje për realizim.

Gjithashtu, vlen të theksohet se shërbimet e veçanta që ofrojmë kërkojnë edhe përgatitje profesionale të veçantë. Andaj, fokus i angazhimeve tona do të jetë përgatitja e kuadrove, qoftë përmes ndonjë iniciative për hapje të drejtimeve shkollore përkatëse në Kosovë, apo edhe përmes trajnimit dhe certifikimit nga institucione e organizata ndërkombëtare relevante.

- **Të priturat për vitin e ardhshëm**

Një prej synimeve tona, padyshim që është planifikimi i investimeve në modernizimin e mjeteve lëvizëse apo edhe në blerjen e mjeteve të reja. Për këtë jemi të vetëdijshëm se është një mision i vështirë, por me ndihmën e Aksionarit dhe me ato pak mundësi tona financiare, pa lënë anash edhe mundësinë për gjetjen e donatorëve apo formave tjera për investim shpresojmë se do t'ia dalim.

Për këtë qëllim, kemi hartuar edhe Planin Investiv Afatmesëm, në të cilin planifikohet që krahas me zhvillimet në infrastrukturën hekurudhore të bëhen edhe investimet në mjetet lëvizëse.

Përkundër sfidave me të cilat ballafaqohemi, vitin e ardhshëm presim arritjen e objektivave të parapara në planin e biznesit për vitin 2020 siç është rritja e transportit të mallrave vendor dhe ndërkombëtarë si dhe rritje në transportin e udhëtarëve.

## II. 2. INFORMACIONE LIDHUR ME KAPITALIN DHE DIVIDENTEN

Gjatë vitit 2019 ndërmarrja ka zhvilluar procedurat për projektet kapitale, përkatësisht procedurat për realizimin e projektit për furnizim me tren motorik, mirëpo nuk është arritur që të kemi ndonjë ofertë për këtë projekt.

Mjetet për projektet kapitale në shumën prej 800,000.00 € të ndara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2019 nuk janë shfrytëzuar në tërësi, janë realizuar vetëm një pjesë e projekteve, apo shprehur në % është realizuar 25% e shumës së ndarë.

Një e dhënë tjetër që duhet theksuar është edhe fakti se Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. gjatë këtij viti nuk kanë nënshkruar asnjë marrëveshje kredituese gjë e cila na bën të ndihemi mirë pasi që ndërmarrjen nuk e kemi futur në asnjë borxh që do të ndikonte negativisht në zhvillimet e mëtejme.

Ndërsa, sa i përket shpërndarjes së **dividentës**, ndërmarrja nuk ka arritur atë nivel të realizimit (fitimit) për ta ndarë atë ashtu siç është e paraparë me aktet juridike të cilat rregullojnë këtë çështje.

## II. 3. TË DHËNAT PËR DREJTORËT JO-EKZEKUTIVË

Duke Pasur parasysh vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/96, të datës 02.04.2019, për emërimin e Bordit të HK-Trainkos Sh.A, të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë në këtë pjesë të raportit do të pasqyrohen edhe për Bordin e Drejtorëve që ka funksionuar deri më 02.04.2019.

Struktura e Bordit të Drejtorëve deri më datën 02.04.2019 ka qenë e përcaktuar në bazë të disa vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe akteve tjera: Vendimit për emërimin e Bordit të Drejtorëve nr. 06/49 të datës 16.09.2015; Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 15/05 të datës 29.09.2017 për shkarkimin e një drejtori të Bordit dhe dorëheqjen e një drejtori tjetër nga Bordi më datë 22.09.2017.

Bazuar në vendimet e theksuara më sipër dhe në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve në emër të Aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të.

Gjatë vitit 2019 janë mbajtur gjithsejtë 13 mbledhje të Bordit të Drejtorëve, tri prej tyre janë mbajtur deri më datën 02.04.2019 dhe 10 (dhjetë) mbledhje tjera janë mbajtur pas kësaj date duke llogaritur edhe Mbledhjen e Kuvendit Vjetor të Aksionarëve.

Në pjesën në vijim do të pasqyrohen të dhënat e vendosura në tabela për strukturën e Bordit të Drejtorëve, Komisionin e Auditimit dhe të komiteteve të cilat kanë funksionuar gjatë vitit 2019.

### Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë deri më datën 02.04.2019

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Pozita | Pjesëmarrja në mbledhje |
|---|---|---|---|
| 1 | Sadik Kryeziu | Kryesues | 3 |
| 2 | Naim Gashi | Anëtar | 3 |
| 3 | Bastri Sallahu | Anëtar | 3 |
| 4 | Mustafa Mustafa | Anëtar | 3 |
| 5 | Gelor Shala | Kryeshef Ekzekutiv | 3 |
| 6 | Afrim Kuleta | Sekretar | 3 |

Sipas të dhënave në tabelën më sipër, Bordi i Drejtorëve që ka funksionuar deri më 02.04.2019, gjatë kësaj periudhe ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje.

### Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë pas datës 02.04.2019

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Pozita | Pjesëmarrja në mbledhje |
|---|---|---|---|
| 1 | Ramush Ahmetaj | Kryesues | 10 |
| 2 | Agim Preniqi | Anëtar | 10 |
| 3 | Fejzi Kiqina | Anëtar | 10 |
| 4 | Ylber Shabani | Anëtar | 10 |
| 5 | Mustafa Mustafa | Anëtar | 9 |
| 6 | Ramiz Rrustaj | Anëtar | 10 |
| 7 | Gelor Shala | Kryeshef Ekzekutiv | 9 |
| 8 | Afrim Kuleta | Sekretar | 10 |

Sipas të dhënave në tabelën më sipër, Bordi i Drejtorëve pas datës 02.04.2019, ka mbajtur gjithsej dhjetë mbledhje, duke përfshirë edhe Mbledhjen e Përgjithshme me Aksionarin.

## II. 4. KOMITETET E BORDIT TË DREJTORËVE TË HK – TRAINKOS Sh. a.

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe arritjes së performancës së kompanisë, punën e Bordit të Drejtorëve e kanë ndihmuar edhe komitetet e krijuara nga vetë Bordi si dhe Komisioni i Auditimit i cili është formuar nga Aksionari.

Kontributi i komiteteve ka qenë tejet i rëndësishëm në definimin e shumë çështjeve dhe lehtësimin e punëve të Bordit. Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim të dhënat për përbërjen e këtyre komiteteve, kohën e funksionimit si dhe numrin e takimeve të mbajtura gjatë vitit 2019.

**Të dhënat për Komisionin e Auditimit dhe komitetet e Bordit që kanë funksionuar deri më datën 02.04.2019:**

| Komiteti (koha e funksionimit) | Emri dhe Mbiemri | | Pozita | Pjesëmarrja në mbledhje |
|---|---|---|---|---|
| KOMISIONI I AUDITIMIT 11.01.2018[1] – 02.04.2019 | 1 | Naim Gashi | Kryesues | 3 |
| | 2 | Basri Sallahu | Anëtar | 3 |
| | 3 | Mustafa Mustafa | Anëtar | 3 |
| KOMITETI PËR HULUMTIME DHE TEKNOLOGJI 31.08.2017 – 02.04.2019 | 1 | Naim Gashi | Kryesues | 1 |
| | 2 | Basri Sallahu | Anëtar | 1 |

**Të dhënat për Komisionin e Auditimit dhe komitetet e bordit që kanë funksionuar pas datës 02.04.2019 janë prezantuar në vijim:**

| Komiteti (koha e funksionimit) | Emri dhe Mbiemri | | Pozita | Pjesëmarrja në mbledhje |
|---|---|---|---|---|
| KOMISIONI I AUDITIMIT 02.04.2019 - aktiv | 1 | Ramiz Rrustaj | Kryesues | 9 |
| | 2 | Fejzi Kiqina | Anëtar | 9 |
| | 3 | Agim Preniqi | Anëtar | 9 |
| KOMITETI PËR HULUMTIME DHE TEKNOLOGJI 28.05.2019 - 26.12.2019 | 1 | Agim Preniqi | Kryesues | 2 |
| | 2 | Ylber shabani | Anëtar | 2 |

***Në emër të Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A***
Ramush Ahmetaj – Kryesues

[1] Në bazë të Vendimit të Ministrit të MZHE, nr. 01/29 të datës 11.01.2018 është bërë plotësim/ndryshimi i Vendimit nr. 01/2401 të datës 09.10.2015, përkatësisht plotësim ndryshimi i përbërjes së Komisionit të Auditimit.

# III. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Ndërmarrja HK-Trainkos Sh. A. arriti që vitin 2019 ta përmbyll me vështirësi si rezultat i shumë faktorëve. Mosfunksionimi normal në transportin e mallrave për shkak të konkurencës jo lojale, borxhet e akumuluara në vitet paraprake nga mos mbulimi i plotë i shpenzimeve të krijuara në transportin e udhëtarëve dhe faktorët tjerë teknik dhe teknologjik kanë ndikuar në gjendjen e përgjithshme të ndërmarrjes.

Përkundër angazhimit të vazhdueshëm të stafit ekzekutiv dhe drejtues të ndërmarrjes për zhvillimin e biznesit dhe përformancës në ndërmarrje, sfidat me të cilat po ballafaqohemi në të shumtën e rasteve vijnë si faktorë të jashtëm dhe kanë ndikuar negativisht.

Qasja vetëm në një portë doganore – linjë ndërkombëtare, ka limituar në masë të madhe mundësinë e rritjes së transportit ndërkombëtar të mallrave (export - import), aktualisht transporti ndërkombëtar hekurudhor zhvillohet vetëm përmes Maqedonisë, kufiri në veri qëndron i mbyllur për arsye të ditura politike edhe pse në aspektin teknik linja hekurudhore është e operueshme, ky fakt ka hendikepuar në mas të madhe funksionimin normal në transportin e mallrave duke bërë që shumë klient potencial të orientojnë transportin duke zgjidhur alternativa tjera.

Tregu i transportit vendor të mallrave nuk ka qenë i kënaqshëm në pjesën më të madhe të vitit, si rrjedhojë e liberalizimit të tregut duke mos u respektuar rregullat dhe standardet e operimit në transportin hekurudhor. Është krijuar konkurrencë jolojale që ka ndikuar negativisht në përformancen e ndërmarrjes duke pas parasysh që ne si ndërmarrje jemi të obliguar dhe respektojmë të gjitha standardet për operim.

Vazhdojnë të mbetën sfidë, fondet e pamjaftueshme për investime kapitale në modernizimin dhe rritjen e flotës operuese, mjetet me të cilat operojmë janë të vjetra dhe si rrjedhojë krijojnë edhe shpenzime të mëdha.

Sfidat e cekura më lart ndikojnë drejtpërsëdrejti në përformancën e biznesit të ndërmarrjes. Gjithsesi duke u bazuar në këto rrethana, me investim të vazhdueshëm që ndikojnë në uljen e shpenzimeve, duke u përqendruar në zhvillim të vazhdueshëm të ofertës dhe përmirësim koherent të shërbimit dhe njëkohësisht duke e rritur efikasitetin e strukturës organizative, kemi arritur një përformancë biznesore të kënaqshme, siç do të paraqitet në mënyrë të detajuar në raport.

Puna dinamike në funksion të përshtatshmërisë të rregulloreve të brendshme me legjislacionin në fuqi ka vazhduar edhe gjatë vitit 2019, po ashtu është trajtuar edhe aspekti i përshtatshmërisë me direktivat e Bashkimit Evropian dhe rregullave ndërkombëtare të operimeve në transportin hekurudhor.

Sa i përket realizimit të detyrave dhe respektimit të afateve ligjore të raportimit, ndërmarrja ka arritur që këto obligime t'i përmbush me sukses. Trainkos Sh.A. me kohë ka hartuar

Planin e Biznesit, është pajisur me licencat e nevojshme të operimit nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) dhe në vazhdimësi ka raportuar tek aksionari mbi zhvillimet në kompani.

Kemi ndërtuar një ofertë të mirë për transport hekurudhor të mallrave dhe udhëtarëve, që ofron siguri, saktësi dhe çmime të volitshme dhe konkurruese të tregut. Në të njëjtën kohë jemi angazhuar maksimalisht që oferta jonë të arrijë te çdo klientë potencialë duke përdorur forma të avancuara të promovimit dhe shitjes duke shtuar kujdesin për konsumatorët e shërbimeve tona.

Përkundër realizimit të disa projekteve, sfida kryesore për zhvillimin e gjithë biznesit të HK - Trainkos Sh. A. padyshim mbetet investimi në flotën e mjeteve lëvizëse (lokomotiva, vagonë dhe trena motorikë), ku duke pasur parasysh mjetet që i kemi nga buxheti i Kosovës është shumë vështir që modernizimi të bëhet në masën e kërkuar për operim të rregullt.

Prandaj duke pasur parasyshë gjendjen aktuale të mjeteve lëvizëse, vjetërsisë së tyre dhe amortizimit, kërkohen investime emergjente.

Vlen të theksohet se kjo gjendje e mjeteve lëvizëse që kemi në parkun tonë është si rezultat i buxhetit të vogël të ndarë nga ana Qeverisë së Republikës së Kosovës për Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. A.

Mjetet e ndara për projektet kapitale në vitin 2019 janë shfrytëzuar në disa projekte të rëndësishme për kompaninë, por megjithatë gjendja ende nuk është e kënaqshme sa i përket mjeteve lëvizëse.

Fillimi i investimeve në modernizimin e rrjetit hekurudhor është shumë më rëndësi për zhvillimin hekurudhor, por nga kjo kërkohet që investimet të shtohen edhe në modernizimin e mjeteve lëvizëse të HK-Trainkos Sh. A.

Jemi të përkushtuar që të kemi angazhim maksimal për një zhvillim të gjithmbarshëm të kompanisë. Në kuadër të këtij përkushtimi do të kemi një plan afatmesëm strategjik për zhvillimin e kompanisë dhe ballafaqimin me rreziqet e natyrave të ndryshme të biznesit tonë. Do të vendosim objektiva të qarta mbi mundësinë e zgjerimit të pakos së shërbimeve që ofron kompania, për kompletimin e flotës së mjeteve lëvizëse, për zgjerimin e linjave të transportit dhe do të vazhdojmë me veprime konkrete në kuptim të rritjes së efikasitetit organizativ të kompanisë.

**Kryeshef Ekzekutiv**
**Gelor Shala**

## III. 1. NGJARJET KRYESORE TË VITIT

Ngjarjet kryesore më rëndësi të veçantë që e kanë shoqëruar TRAINKOS-in gjatë vitit 2019 janë të paraqitura si në vijim:

- Vazhdimi i zbatimit të Marrëveshjes për Obligimin e Shërbimeve Publike (OSHP) 2018 – 2022 për Transportin e Udhëtarëve në linjat hekurudhore të aprovuara paraprakisht dhe pagesa e obligimeve të bartura nga MIT-ja nga viti fiskal 2018 që lehtësoj TRAINKOS-it pagesën e humbjeve të krijuara për këtë shërbim;

- Zbatimi i kontratës dhe vazhdimi i së njëjtës për transportin vendor dhe ndërkombëtarë të xehes së nikelit me klientin kryesorë NewCoFeronikeli;

- Përgatitja dhe aprovimi nga Bordi i Drejtorëve i TRAINKOS-it (më 29.10.2019) të "Planit Afatmesëm Investiv 2020 – 2024", dokument që përmban planifikimet pesë vjeçare të TRAINKOS-it sipas rrjedhave deri tani të konfirmuara në sektorin hekurudhorë në përgjithësi;

- Gjatë vitit 2019 me iniciativën e SEETO-s, me udhëheqjen e procesit nga ARH-ja dhe në bashkëpunim me akterët tjerë përgjegjës për legjislacion mbrenda shtetit të Kosovës është diagnostifikuar gjendja e sektorit hekurudhorë me legjislacion dytësorë që rregullon funksionimin e hekurudhave në vend. Kjo gjendje është prezantuar tek akterët kryesorë dhe përgjegjës të BE-së, pritet që kjo iniciativë të zbatohet dhe të financohet nga BE-ja paralelisht për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimorë;

- Zbatimi i projektit "Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore", sektori Fushë Kosovë – Hani i Elezit ka filluar në vitin 2019, kompania GCF (Generale Construcioni Ferroviarie S.p.A.) është fituese e tenderit të stërvonuar dhe ka filluar zbatimin e projektit. TRAINKOS-i tanimë ka identifikuar fushat për bashkëpunim me këtë kompani dhe priten marrëveshje në interes të kompanisë gjatë zbatimit të këtij projekti dy vjeçar;

- Aktiviteti biznesor me partnerët regjional gjatë vitit 2019 vazhdon të kufizohet në iniciativa minore për bashkëpunim regjional dhe bilateral me shtetet e regjionit, këto iniciativa janë të kufizuara kryesisht me shtetin e Maqedonisë Veriore nëse e kemi parasysh që aktualisht është lidhja e vetme ndërkombëtare hekurudhore dhe

- Iniciativat për krijimin e mundësive të funksionalizimit të linjës hekurudhore në Veri, konkretisht me serbinë është një ngjarje që imponon përgatitjet e domosdoshme të infrastrukturës dhe operimit në këto linja.

# IV. PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE E TRAINKOS SH. A.

Në këtë raport vjetor të punës do të paraqesim indikatorët fizik të performancës operative nga 01 Janari deri më 31 Dhjetor 2018, duke prezantuar realizimin e detyrave në krahasim me planifikimin që është bërë për të njëjtën periudhë raportuese me planin e Biznesit të vitit 2019, si dhe duke krahasuar realizimin e vitit paraprak 2018, për të njëjtën periudhë raportuese. Natyrisht do të komentojmë ndryshimet që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe.

## IV. 1 DEPARTAMENTI I TRANSPORTIT TË MALLRAVE

Departamenti i transportit të mallrave është njëri prej sektorëve që ka rolin kryesor për ndërmarrjen. Rezultatet e arritura nga ky departament në vitin 2019 janë prezantuar në vijim, ku sasia e mallrave të transportuara është shprehur në ton.

| Përshkrimi – Sasia e Transportuar | Janar – Dhjetor 2018 - Ton |
|---|---|
| Realizimi Neto Ton në 2018 | 268,700.13 |
| Realizimi Neto Ton në 2019 | 487,932.22 |
| Planifikimi Neto Ton në 2019 | 610,712.00 |
| Realizim 2019 – Realizim 2018 | 219,232.09 |
| Realizim – Planifikim në 2019 | - 122,779.78 |
| Realizim 2019 – Realizim 2018 (%) | 182 % |
| Realizim 2019 – Planifikim 2019 (%) | 80 % |

**Tabela 4.1.1**

Siç mund të shihet nga tabela 4.1.1 në këtë periudhë kohore kemi transportuar për rreth 82% më shumë se sa në të njëjtën periudhë raportuese për vitin e kaluar dhe 20% më pak se sa sasia e planifikuar për këtë periudhë.

Transporti i mallrave me kontejnerë gjatë vitit 2019 ka qenë:

| Përshkrimi – Numri i Transportuar i kontejnerëve | Janar – Dhjetor 2018 |
|---|---|
| Kontejnerë të plotë - 2019 | 00.00 copë |
| Kontejnerë të plotë/zbrazët - 2019 | 00.00 copë |

**Tabela 4.1.2**

**Sasia e transportuar në Neto ton për vitin 2019**





**Figura 4.1.1**

Siç mund të shihet nga figura 4.1.1 në aspektin operativ kemi arritur të realizojmë 80 % nga planifikimi për periudhën raportuese Janar- Dhjetor 2019

Të hyrat nga transporti i mallrave për periudhën raportuese janë

| Përshkrimi | Të hyrat në periudhën vjetore 2019 në € |
|---|---|
| Realizim shitje të hyra 2018 | 587,888.36 |
| Realizim shitje të hyra 2019 | 1,005,764.53 |
| Planifikimi 2019 | 1,385,633.78 |
| Realizim 2019 - Realizim 2018 | 417,876.20 |
| Realizim – Planifikim 2019 | -379,869.20 |
| Realizim 2018 - Realizim 2019 (%) | 171 % |
| Realizim – Planifikim 2019 (%) | 73 % |

**Tabela 4.1.3**

Siç mund të shihet nga tabela 4.1.3 Neto Ton të shprehura në të hyra me vlerë euro, kemi arritur 73 % realizim nga planifikimi, për periudhen Janar – Dhjetor 2019 sipas Planit të Biznesit.

**Të hyrat në periudhën vjetore 2019**





**Figura 4.1.2**

**Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i mallrave**

| Përshkrimi | Të hyrat dhe shpenzimet € |
|---|---|
| Shitjet nga transporti i mallrave | 1,005,764.53 |
| Të ardhura tjera nga transporti i mallrave | 29,939.97 |
| Total shitjet | 1,035,704.50 |
| Shpenzimet direkte në transportin e mallrave | 880,734.88 |
| Shpenzimet indirekte në transportin e mallrave | 410,587.42 |
| Total shpenzimet | 1,291,322.30 |
| Fitimi/humbja operative | - 255,617.80 |
| Fitimi/humbja në % | - 20% |

**Tabela 4.1.4**

Siç mund të shihet nga tabela 4.1.4 Duke u bazuar në Planin e Biznesit për vitin 2019 kemi një humbje prej 20 % nga të hyrat krahasuar me shpenzimet për periudhen Janar – Dhjetor 2019.

## IV. 2 TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Në fushën e sektorit të transportit të udhëtarëve gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur rezultate të kënaqshme krahasuar me vitin e kaluar.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur krahasimet e përgjithshme të të dhënave të realizuara në periudhën Janar - Dhjetor 2019 me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Në këtë tabelë shihet se kemi ngritje të numrit të udhëtarëve në këtë vit krahasuar me numrin e udhëtarëve për vitin e kaluar.

| Përshkrimi - Udhëtarë | Numri i Udhëtarëve |
|---|---|
| Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2018 | 118,466 |
| Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2019 | 120,309 |
| Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2019 | 180,000 |
| Dallimi: Realizim 2019 - 2018 | 1,843 |
| Dallimi: Realizim - Planifikimi 2019 | -59,691 |
| Dallimi: 2019 - 2018 | 1.56 |
| Dallimi: Realizim - Planifikimi 2019 | -33.16 |

**Tabela 4.2.1**

Siç shihet nga shënimet e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore kemi pasur një numër më të madh të udhëtarëve krahasuar me vitin e kaluar apo 1.56 % më shumë dhe 33.16 % më pak kundrejt planifikimit. Vlen të theksohet se nuk kemi mekanizëm për përcaktimin e saktë të numrit të udhëtarëve që frekuentojnë transportin hekurudhor duke pasur parasysh edhe kategoritë e liruara nga pagesat.

Në tabelën më poshtë është pasqyruar realizimi i transportit të udhëtarëve në vlera financiare:

| Përshkrimi - Shitje e Biletave | Të hyrat |
|---|---|
| Realizim shitje të hyra 2018 | 97,424.40 |
| Realizim shitje të hyra 2019 | 104,392.25 |
| Planifikimi 2019 | 150,000.00 |
| Dallimi: realizim 2019 - realizim 2018 | 6,967.85 |
| Dallimi: realizim - planifikim 2019 | -45,607.75 |
| Dallimi: realizim 2019 - realizim 2018 | 7.15 |
| Dallimi: realizim - planifikim 2019 | -30.41 |

**Tabela 4.2.2**

Ndërsa reflektimi financiar i transportit të udhëtarëve, siç mund të shihet nga shënimet më lart në këtë periudhë kohore, është 7.15 % më shumë sesa vitin e kaluar për të njëjtën periudhë dhe rreth 30.41 % më pak sesa planifikimi i paraparë për këtë periudhë.





**Figura 4.2.1**

**Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i udhëtarëve**

| Përshkrimi | Të hyrat (janar - dhjetor 2019) |
|---|---|
| Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - OSHP | 1,253,911.55 € |
| Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - MZHE | 500,000.00 € |
| Shitjet nga transporti i udhëtarëve | 104,392.25 € |
| Të hyrat nga shërbimi i ID kartelave: | 584.75 € |
| Të hyrat nga transporti i organizuar për udhëtarë | 1,204.40 € |
| Total të hyrat | 1,860,362.45 € |
| Shpenzimet direkte në TU | 1,065,413.22 € |
| Shpenzimet indirekte në TU | 1,005,231.27 € |
| Total shpenzimet | 2,070,644.49 € |
| Fitimi / humbja operative | 210,282.04 € |

**Tabela 4.2.3**





**Figura 4.2.2**

Siç shihet nga tabela më lart, transportit të udhëtarëve ka operuar me një humbje operative prej – **10.00 %** gjatë periudhës raportuese, duke llogaritur të hyrat nga: OSHP, MZHE-ja si dhe të hyrave nga shitja e biletave të udhëtarëve dhe transporteve të kontraktuara.

**Vërejtje:**

***Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave për këtë periudhë një vjeqare duke marrë për bazë tren-kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e udhëtarëve kanë operuar rreth 71.00% nga totali i tren-kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat.***

## IV. 3. ZYRA E MIRËMBAJTJES SË MJETEVE LËVIZËSE - MML

Në Zyrën e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse përfshihen: mirëmbajtja e trenave motorik, lokomotivave transportuese, lokomotivave manovruese, vagonëve për transportin e udhëtareve, vagonëve për transportin e mallrave dhe punët tjera për riparimin e vagonëve të huaj.

### IV.3.1 Mirëmbajtja e trenave motorik

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve per mirëmbajtjen e trenave motorik të realizuara ne vitin 2019 krahasuar me vitin 2018.

| | Lloji i riparimit/mirëmbajtjes | 2019 | 2018 | Ndryshim |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Servisime | 51 | 200 | -149 |
| 2. | Riparime | 26 | 52 | -26 |
| 3. | Kontrollime K1 | 8 | 14 | -6 |
| 4. | Kontrollime K3 | 2 | 4 | -2 |
| 5. | Kontrollime K6 | 1 | 4 | -3 |
| 6. | Gdhendja e rrotave | 0 | 1 | -1 |

**Tabela 4.3.1**

### IV.3.2 Mirëmbajtja e Lokomotivave Transportuese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve per mirëmbajtjen e lokomotivave transportuese të realizuara në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018.

| | Lloji i riparimit/mirembajtjes | 2019 | 2018 | Ndryshimi |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Servisime | 571 | 398 | 173 |
| 2. | Riparime | 26 | 40 | -14 |
| 3. | Kontrollime K1 | 38 | 30 | 8 |
| 4. | Kontrollime K3 | 10 | 8 | 2 |
| 5. | Kontrollime K6 | 10 | 6 | 4 |
| 6. | Gdhendje te rrotave | 6 | 3 | 3 |

**Tabela 4.3.2**

### IV.3.3 Mirëmbajtja e Lokomotivave Manovruese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve per mirëmbajtjen e lokomotivave manovruese të realizuara në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018.

| | Lloji i riparimit/mirëmbajtjes | 2019 | 2018 | Ndryshimi |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Servisime | 7 | 6 | 1 |
| 2. | Riparime | 4 | 5 | -1 |
| 3. | Kontrollime k1 | 9 | 8 | 1 |
| 4. | Kontrollime K3 | 1 | 2 | -1 |
| 5. | Kontrollime K6 | 2 | 2 | 0 |
| 6. | Gdhendje te rrotave | 0 | 1 | -1 |

**Tabela 4.3.3**

Intervenimet në mjetet tërheqëse gjatë vitit 2019 për secilin mjet tërheqës është dhëne në tabelën në vazhdim:

| Mjeti tërheqëse | 2640 001 | 2640 002 | 2640 003 | 2640 004 | 2620 005 | 2640 006 | 2640 007 | 2640 008 | 2710 009 | 2640 010 | 2620 016 | 2760 001 | 5800 001 | 5800 002 | 5800 004 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| S | | | | | 104 | | 88 | 93 | 2 | 72 | 212 | 7 | 53 | 2 | |
| R | | | | | 5 | | 2 | 9 | 2 | 6 | 2 | 3 | 22 | 3 | 1 |
| K 1 | | | | | 7 | | 8 | 8 | | 8 | 8 | 9 | 7 | | |
| K 3 | | | | | 2 | | 2 | 2 | | 2 | 1 | | 1 | | |
| K 6 | | | | | 3 | | 2 | 2 | | 1 | 2 | 3 | 1 | | |

**Tabela 4.3.4**

S - Servisim,
R - Riparim,
K1 - Kontrollime njëmujor,
K3 - Kontrollime tremujor,
K6 - Kontrollime gjashtëmujor

## IV.3.4 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtareve

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimvev të komponenteve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve te udhetareve te realizuara ne vitin 2019 krahasuar me vitin 2018.

| | Lloji i riparimit/mirembajtjes | 2019 | 2018 | Ndryshimi |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Kontrollime K1 | 103 | 113 | -10 |
| 2. | Riparim në punëtori | 40 | 34 | 6 |
| 3. | Kontrollime në stacion | 50 | 365 | -315 |
| 4. | Gdhendje të rrotave | 14 | 8 | 6 |
| 5. | Testim i komponentave | 6 | 2 | 4 |

**Tabela 4.3.5**

### IV.3.5 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimvev të komponenteve, kontrollimeve dhe riparimeve per mirëmbajtjen e vagoneve te mallrave te realizuara ne vitin 2019 krahasuar me vitin 2018.

| | Lloji i riparimit/mirembajtjes | 2019 | 2018 | Ndryshimi |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Kontrollime K3 | - | 66 | - |
| 2. | Riparim në punëtori | - | 13 | - |
| 3. | Riparim në teren | - | 2 | - |
| 4. | Gdhendje të rrotave | - | 0 | - |

**Tabela 4.3.6**

### IV.3.6 Riparimi i vagoneve të huaj

| Rriparimi/mirembajtja e vagonëve të huaj | 2019 | 2018 |
|---|---|---|
| NewCo Feronikeli | 23,485.50 € | 15,168.00 € |

**Tabela 4.3.7**

# V. PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET

1. Gjendja financiare janar – dhjetor 2019
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.12.2019)
3. Bilanci i gjendjes,

## V. 1. Gjendja financiare

Për periudhën raportuese janar – dhjetor 2019, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

### V. 1. 1. Të hyrat

Nga **Transporti i mallrave** kemi realizuar të hyrat prej 1,005,764.53€ për periudhën janar - dhjetor 2019. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2019, është 1,385,633.75€ dhe nga kjo shohim se kemi realizuar 72.59 % nga totali. Të hyrat nga transporti i mallrave eksport/import janë realizuar sipas kategorive që pasojnë: të hyrat nga importi i kemi realizuar përmes vijës kufitare Hani i Elezit janë 431,743.23€ dhe nga eksporti po ashtu përmes vijës kufitare Hani i Elezit kemi realizuar shumën prej 681.99€.Transporti i brendshëm kryesisht është realizuar për "NewCo Ferronikeli" dhe atë në transportin e xehes nga Medveci. Në këtë periudhë nga ky lloj i transportit është realizuar shuma prej 573,339.31€.

**Transporti i udhëtarëve** për periudhën janar – dhjetor 2019, është realizuar në shumën prej 1,859,849.19€. Nga të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar janë 1,253,911.55€, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej 500,000.00€. Burimi i të ardhurave nga biletat është realizuar në shumën prej 105,934.64€, shprehur në përqindje më realizimin e të hyrave nga transporti i udhëtarëve kemi arritur shumën e realizimit 97.21%, krahasuar me planifikimet e vitit 2019 – 1,913,175.98€.

**Të hyrat nga shërbimet tjera** gjatë periudhës janar - dhjetor 2019, kanë arritur shumën prej 29,939.97€. Kjo shumë nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2019, e cila është 40,000.00€ arrin kuotën prej 74.85%. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionin të hyrat nga RIV-i dhe vendosjet –29,939.97€.

**Të hyra tjera** të cilat janë realizuar gjatë periudhës janar – dhjetor 2019, kanë arritur shumën prej 67,983.17€. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siq vijojnë: Të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh. A. – 31,803.26€, te hyrat nga dëmtimi i vagonëve dhe të tjera në vlerë prej 36,179.91€.Buxheti i planifikuar është 90,000.00€, shprehur ne përqindjen 75.53%.

## V. 1. 2. Shpenzimet

**Shpenzimet** për periudhën janar – dhjetor 2019, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

**Totali i kostos së shërbimit** për periudhën është 1,247,717.81€ nga 1,250,065.36€ të planifikuara për vitin 2019 dhe arrijnë kuotën prej 99.81%. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2019.

**Shpenzimet e stafit** është kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 1,819,598.92€, dhe atë në paga dhe kontribute – 1,811,202.31€ dhe sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera – 8,396.61€. Në total nëse e krahasojmë shumën e buxhetuar për vitin 2019 – 1,800,000.00€, në këtë kategori kemi arritur kuotën prej 101.09%.

**Totali i shpenzimeve operative** kapë shumën prej 128,600.20€, kjo shumë është 12.97% nga shuma prej 991,300.00€ e parashikuar vitin 2019. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e më poshtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2019.


**Totali i shpenzimeve administrative** ka arritur në kuotën prej 80.55%, konkretisht në shumën prej 146,197.44€. Planifikimi per vitin 2019, i kësaj kategorie është 181,500.00€. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2019.

**TABELA 1. TË HYRAT DHE SHPENZIMET OPERATIVE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2019**


| | EMËRTIMI | Realizimi Janar-Dhjetor 2019 | Buxheti 2019 | Diferenca | B/C (%) | Realizimi Janar – Dhjetor 2018 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A | B | C | D | E | F |
| A | Shitjet | | | | | |
| 1 | Transporti i mallrave | 1,005,764.53 | 1,385,633.75 | (379,869.22) | 72.59 | 561,178.20 |
| 2 | TU – Ministria e Infrastruktures | 1,253,911.55 | 1,263,175.98 | (9,264.43) | 99.27 | 1,170,612.35 |
| 3 | TU – Ministria e Zhvillimit Ekonomik | 500,000.00 | 500,000.00 | - | 100.00 | 500,000.00 |
| 4 | TU – Shitja e Biletave | 105,934.64 | 150,000.00 | (44,065.36) | 70.62 | 98,957.62 |
| 5 | Shërbimet tjera | 29,939.97 | 40,000.00 | (10,060.03) | 74.85 | 23,560.91 |
| 6 | Të ardhurat – Dëmtimi i vagonave | 27,483.90 | 50,000.00 | (22,516.10) | 54.97 | 38,728.59 |
| 7 | Të hyrat tjera jo operative | 40,499.27 | 40,000.00 | 499.27 | 101.25 | 59,199.45 |
| I | TOTAL – TË HYRAT | 2,963,533.86 | 3,428,809.73 | (465,275.87) | 86.43 | 2,452,237.12 |
| B | Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve | | | | | |
| 1 | Derivatet dhe lubrifikantet | 595,968.13 | 607,934.83 | (11,966.70) | 98.03 | 464,865.85 |
| 2 | Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale | 40,451.59 | 35,000.00 | 5,451.59 | 115.58 | 10,104.37 |
| 3 | Inventar dhe pajisje | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 111.53 |
| 4 | Material harxhues | 0.00 | 1,314.23 | (1,314.23) | 0.00 | 198.69 |
| 5 | Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera | 25,577.17 | 30,000.00 | (4,422.83) | 85.26 | 23,042.68 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Qasja në binarë | 495,300.76 | 488,816.30 | 6,484.46 | 101.33 | 380,258.50 |
| 7 | Sigurimi i palëve të treta | 1,365.00 | 3,000.00 | (1,635.00) | 45.50 | 1,977.97 |
| 8 | Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj | 57,346.54 | 40,000.00 | 17,346.54 | 143.37 | 31,788.95 |
| 9 | Shpenzimet e transportit Infrakos | 31,708.62 | 44,000.00 | (12,291.38) | 72.07 | 43,609.00 |
| 10 | Zbritjet e lejuara | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 6,238.10 |
| | TOTAL – KOSTOJA E SHERBIMIT | 1,247,717.81 | 1,250,065.36 | (2,347.55) | 99.81 | 962,195.64 |
| | Fitimi (humbja) bruto | 1,715,816.05 | 2,178,744.37 | (462,928.32) | 78.75 | 1,490,041.48 |
| | TE ARDHURAT TJERA | | | | | |
| 1 | Te Ardhura të jashtëzakonshme | 300,000.00 | 0.00 | 300000.00 | 0.00 | 0.00 |
| 2 | Zbritjet e mara | 2,313.28 | 0.00 | 2,313.28 | 0.00 | 7,005.33 |
| 3 | Te ardhura tjera | - | 800,000.00 | (800,000.00) | 0.00 | - |
| | TOTAL – Te ardhurat tjera | 302,313.28 | 800,000.00 | (497,686.72) | 37.79 | 7,005.33 |
| C | Shpenzimet e stafit | | | | | |
| 1 | Pagat dhe kontributet | 1,811,202.31 | 1,790,000.00 | 21,202.31 | 101.18 | 1,696,783.67 |
| 2 | Sigurimi shendetsor, trajnime dhe Shpenzime tjera | 8,396.61 | 10,000.00 | (1,603.39) | 83.97 | 5,009.77 |
| | TOTAL - Shpenzimet e stafit | 1,819,598.92 | 1,800,000.00 | 19,598.92 | 101.09 | 1,701,793.44 |
| D | Shpenzimet operative | | | | | |
| 1 | Mirëmbajtje dhe riparime | 8,216.34 | 810,000.00 | (801,783.66) | 1.01 | 31,124.45 |
| 2 | Sigurimi fizik – total | 0.00 | 25,000.00 | (25,000.00) | 0.00 | 34,124.79 |
| 3 | Shërbimet tjera | 0.00 | 20,500.00 | (20,500.00) | 0.00 | 2,847.30 |
| 4 | Blerja e automjeteve per nevojat e kompanise | 0.00 | 25,000.00 | (25,000.00) | 0.00 | 0.00 |
| 5 | Shpenzimet logjistike | 19,927.49 | 12,000.00 | 7,927.49 | 166.06 | 25,487.48 |
| 6 | Energjia elektrike dhe komunalite | 3,881.08 | 10,000.00 | (6,118.92) | 38.81 | 4,764.74 |
| 7 | Sigurimi i palëve të treta | 3,482.16 | 2,000.00 | 1,482.16 | 174.11 | 2,485.68 |
| 8 | Marketingu | 1,313.61 | 15,000.00 | (13,686.39) | 8.76 | 1,852.54 |
| 9 | Udhëtimet zyrtare | 569.98 | 4,000.00 | (3,430.02) | 14.25 | 392.05 |
| 10 | Telefonat dhe Posta | 14,580.81 | 22,000.00 | (7,419.19) | 66.28 | 20,741.15 |
| 11 | Shërbimet bankare | 865.00 | 800.00 | 65.00 | 108.13 | 809.55 |
| 12 | Tatimet | 65,054.12 | 30,000.00 | 35,054.12 | 216.85 | 33,727.05 |
| 13 | Pajisje elektronike | 10,709.61 | 15,000.00 | (4,290.39) | 71.40 | 2,449.48 |
| | TOTAL - Shpenzimet operative | 128,600.20 | 991,300.00 | (862,699.80) | 12.97 | 160,806.26 |
| E | Shpenzimet administrative | | | | | |
| 1 | Inventar dhe pajisje | 0.00 | 6,000.00 | (6,000.00) | 0.00 | 337.63 |
| 2 | Konsulenca dhe auditimi i jashtëm | 2,542.38 | 4,000.00 | (1,457.62) | 63.56 | 6,439.84 |
| 3 | Material i zyrës | 4,662.50 | 9,000.00 | (4,337.50) | 51.81 | 6,846.91 |
| 4 | Material sanitar | 1,558.32 | 4,000.00 | (2,441.68) | 38.96 | 1,962.84 |
| 5 | Qiraja për objektet | 8,029.67 | 10,000.00 | (1,970.33) | 80.30 | 8,499.22 |
| 6 | Reprezentacioni dhe bufeja | 2,562.37 | 3,500.00 | (937.63) | 73.21 | 3,499.90 |
| 7 | Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet | 123,479.65 | 120,000.00 | 3,479.65 | 102.90 | 27,492.17 |
| 8 | Shpenzimet logjistike | 3,188.55 | 15,000.00 | (11,811.45) | 21.26 | 5,197.68 |
| 9 | Kontigjente | 174.00 | 10,000.00 | (9,826.00) | 1.74 | 1,065.93 |
| | TOTAL - shpenzimet administrative | 146,197.44 | 181,500.00 | (35,302.56) | 80.55 | 61,342.12 |
| | Provizionet e borgjeve të këqija | 15,322.65 | - | 15,322.65 | 0.00 | 24798.00 |
| II | TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E) | 3,357,437.02 | 4,222,865.36 | (865,428.34) | 79.51 | 2,910,935.46 |
| III | Fitimi (Humbja) para zhvlersimit | (91,589.88) | 5,944.37 | (97,534.25) | -1540.78 | -451,693.01 |
| | GRANTET | 1,036,279.98 | 1,033,836.16 | 2,443.82 | 100.24 | 1,007,383.44 |
| F | Shpenzimet e zhvlerësimit | | | | | |
| 1 | Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve | 1,036,279.98 | 1,033,836.16 | 2,443.82 | 100.24 | 1,007,383.44 |
| 2 | Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë | 27,542.52 | 24,957.32 | 2,585.20 | 110.36 | 24,617.13 |
| | TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit | 1,063,822.50 | 1,058,793.48 | 5,029.02 | 100.47 | 1,032,000.57 |
| G | Fitimi (humbja) nga veprimtaria | (119,132.40) | (19,012.95) | (100,119.45) | 626.59 | -476,310.14 |

**Diagrami 1 – Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit për vitin 2019**




**Diagrami 2 – Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive për vitin 2019**




## V. 2 Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës (31.12.2019)

| Nr | EMËRTIMI | Saldo 31-12-2019 |
|---|---|---|
| 1 | PCB nr. 1114-004229-0001-59 | 305.67 |
| 2 | PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50 | 0.00 |
| 3 | BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41 | 1,465.67 |
| 4 | BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32 | 1,248.64 |
| 5 | BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23 | 66,978.90 |
| 6 | GH-PCB nr. 1114004229040114 | 0.00 |
| 7 | BPB | 40,910.45 |
| | **Totali** | **110,909.33** |

**Tabela 5.2.1**

## V. 3 Bilanci i gjendjes

| BILANCI I GJENDJES | | |
|---|---|---|
| **NP TRAINKOS SH.A** | **GJENDJA FILLESTARE 01/01/19** | **GJENDJA PERFU. 31/12/19** |
| | | |
| **Mjetet themelore - vlera neto sipas librave** | **5,499,876.89** | **4,607,813.66** |
| **Mjetet Qarkulluese** | **2,820,464.19** | **2,490,121.79** |
| Stoqet | 429,002.01 | 437,320.30 |
| Paraja | 54,938.35 | 111,501.53 |
| Llogarite e arketueshme | 1,871,622.66 | 1,467,002.44 |
| Kerkesa tjera te arketushme | 440,107.68 | 460,246.52 |
| Parapagimet | 24,793.49 | 14,051.00 |
| **Total Mjetet Qarkulluese dhe themelore** | **8,320,341.09** | **7,097,935.45** |
| **Detyrimet afatshkurta** | **1,898,848.82** | **1,624,287.45** |
| Llogarite e pagueshme | 1,549,822.50 | 1,092,572.90 |
| Te pagueshme tjera - detyrime | 3,140.61 | 3,410.39 |
| Detyrime tatimore | 345,885.71 | 528,304.16 |
| Llogarite tjera | | |
| **Detyrimet afatgjata** | **3,186,968.59** | **2,343,782.20** |
| **Kapitali** | **5,305,403.20** | **5,323,807.41** |
| Fitimi/Humbja e bartur | -2,070,879.52 | -2,074,121.05 |
| Fitim/ Humbja e vitit | | -119,820.56 |
| **Total detyrimet dhe kaptali** | **8,320,341.09** | **7,097,935.45** |

**Tabela 5.3.1**

## VI. PROJEKTET KAPITALE TË HK - TRAINKOS SH. A.

Vlera e investimeve (tabela 6.1) është e ndarë në projekte kapitale të cilat janë të financuara nga Buxheti i Kosovës dhe shpenzimeve operative qe janë mbuluar nga Buxheti Operativ i Kompanisë.

Vlera e këtyre projekteve të financuara nga Buxheti i Kosovës është **196,577.00 €.**
Projekte të cilat janë financuar nga Buxheti i Kosovës janë shtatë, ku të gjitha janë realizuar me sukses dhe janë në shfrytëzim.

Të gjitha projektet tjera janë të financuara nga Buxheti Operativ i Trainkos Sh.A.
Vlera e këtyre projekteve dhe shpenzimeve operative të kontraktuara me procedura të prokurimit janë **834,374.00 €.**

Vlera substanciale në shpenzime operative përbejnë shpenzimet e vajrave dhe furnizimi me naftë.

| Nr | Titulli i Aktivitetit të Prokurimit | Kontraktuar | Buxheti i zotuar | Vlera e kontratës | Koment |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Furnizimi me sistem të centralizuar për menaxhimin e kontabilitetit dhe financave | **Shtator** | 20.000,00 | 16,579.00 | **Ne procedurë** |
| 2 | Renovimi i objektit ndihmës të tërheqjes së trenave | **Shtator** | 67.751,19 | 57,762.25 | **Ne procedurë** |
| 3 | Furnizimi dhe Instalimi i pajisjeve të teknologjisë informative | **Tetor** | 43.000,00 | LOT 1– 31,453.00<br>LOT 2- 12,679.42 | **Ne procedurë** |
| 4 | Renovimi i objektit të pastrimit të vagonëve | **Tetor** | 9.923,00 | 9,892.53 | **Ne procedurë** |
| 5 | Renovimi i objektit të servisit të trenave motorik | **Tetor** | 9.720,00 | 8,368.00 | **Ne procedurë** |
| 6 | Furnizimi me filtra për lokomotiva | **Tetor** | 5.765,00 | 5,492.00 | **Përfunduar** |
| 7 | Shërbimet e sigurimit të palëve të treta | **Mars** | 2.000,00 | 1,610.70 | **Përfunduar** |
| 8 | Furnizim me papuçe frenuese për vagonë | **Tetor** | 7.200,00 | 9,147.36 | **Përfunduar** |
| 9 | Furnizimi me vetura për nevojat e Trainkos SH.A. | **Tetor** | 20.000,00 | 26,231.00 | **Ne procedurë** |
| 10 | Furnizimi me vajra dhe lubrifikante | **2018** | 61,000.00 | 27,761.00 | **Ne procedurë** |
| 11 | Furnizimi me naftë | **2017** | 1,4 mil | 726,164.00 | **Ne procedurë** |
| 12 | Zbrazja e rezervarëve në vagonët e transporti të udhëtarëve me ujëra të zeza | **Korrik** | 2.700,00 | 2,300.00 | **Kontraktuar** |
| 13 | Matja e kënaqshmerisë së klientëve në Transport të mallrave dhe në transport të udhëtarëve për vitin 2019 | **Tetor** | 1,500.00 | 647.00 | **Kontraktuar** |
| 14 | Furnizimi me material administrativ | **Maj** | 6.000,00 | 5,181.08 | **Kontraktuar** |
| 15 | Furnizimi me Toner | **Maj** | 5.000,00 | 3,069.18 | **Kontraktuar** |
| 16 | Furnizimi me kompjuter | **Mars** | 2.000,00 | 1,888.01 | **Përfunduar** |
| 17 | Shërbimet e mirëmbajtjes së arkave fiskale-DP-05 për nevojat e Trainkos Sh.A. | **Shtator** | 6.500,00 | 4,394.30 | **Ne procedurë** |
| 18 | Furnizimi me material higjenik | **Qershor** | 5.000,00 | 4,993.28 | **Kontraktuar** |
| 19 | Furnizimi me kontejner të plumbit për izolim radioaktiv | **Qershor** | 2.000,00 | 1,875.02 | **Kontraktuar** |
| 20 | Furnizimi dhe montimi i klimave për | **Shtator** | 1.800,00 | 1,400.00 | **Përfunduar** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Trainkos Sh.A. | | | | |
| 21 | Furnizimi me pjesë për lokomotivën 2710 009 | **Maj** | 2.550,00 | 2444.44 | **Përfunduar** |
| 22 | Furnizim me modul për Lokomotivën 009 | **Maj** | 2.500,00 | 2,340.00 | **Përfunduar** |
| 23 | Furnizimi me ujë të pijshëm | **Maj** | 4.000,00 | 2,891.00 | **Kontraktuar** |
| 24 | Shërbimet e sigurimit të automjeteve | **Korrik** | 1.600,00 | 1,599.14 | **Përfunduar** |
| 25 | Furnizimi i kompresorit për trenin motorik 5800 001 | **Korrik** | 2.200,00 | 1,444.00 | **Përfunduar** |
| 26 | Pune shtese në projektin Riparimi i tornos për gdhendjen e rrotave të mjeteve lëvizëse | **Shkurt** | 2.500,00 | 2,428.35 | **Përfunduar** |
| 27 | Furnizimi me rërë për lokomotiva | **Dhjetor** | 1,314.23 | 1,218.00 | **Përfunduar** |
| 28 | Furnizime të ndryshme me procedura minimale | **Janar - Dhjetor** | 13,260.00 | 12,494.80 | **Përfunduar** |

**Tabela 6.1**

# VII. ZHVILLIMI I BIZNESIT

## VII.1 Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit

Nëse e kemi parasysh se planfikimet për sektorin hekurudhorë duhet dhe janë afatgjata atëhere edhe synimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës janë që me shfrytëzimin e mundësive që ofrojnë IFN-të dhe Bashkësia Evropiane (BE) dhe me mekanizmat e sajë të bëhet fillimisht investimi në Linjat ekzistuese hekurudhore, pastaj të vazhdohet me Linjat tjera të reja të identifikuara me "Strategjinë Sektoriale dhe Transportin Multimodal 2015 – 2025 dhe Plani i veprimit 5 vjeçar". Viti 2019 është viti i fillimit të projektit "Rehabilitimi i Linjës së 10-të hekurudhore" Hani i Elezit – Leshak. Me këtë fillon procesi i plotësimit të parakushteve të përcaktuara me "Librin e bardhë" të publikuar për zbatim nga BE-ja në mars 2011. Me këtë synohet krijimi i një zone të mirëfilltë të transportit të përbashkët Evropian duke i eliminuar të gjitha pengesat e mbetura nacionale dhe për të lehtësuar integrimin dhe operimin funksional të transportit hekurudhorë multimodal dhe intermodal.

Procedimi i realizimit të projektit sipas planifikimeve në Rehabilitimin e Linjës Lindje – Perëndim do të krijon parakushte për shtrirjen e rrjetit hekurudhorë në pjesën që kalon ky rrjetë dhe plotësojë parakushtet për Linjat e reja që janë paraparë me planifikimet strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Rëndësi të veçantë ka vazhdimi i Linjës hekurudhore nga Prizreni për Shqipëri, realizimi i kësaj lidhje do të mundëson edhe qasjen në Portet e Shqipërisë. Kjo do mundësojë që të avancojë qarkullimin e mallrave me tren jo vetëm për Republikën e Kosovës por edhe shtetet tjera në kontinent nga Portet gjeografikisht strategjike të Shqipërisë.

Një aktivitet që mund të kategorizohet në top sukseset e kësaj periudhe është puna në përgatitjen e "Draftit të Strategjisë Afatmesme të Investimeve për TRAINKOS-in 2020 - 2024". TRAINKOS-i gjatë periudhës së kaluar (që nga ndarja, Shtator 2011) ka pas një aktivitet të ngjeshur në prezantimin e nevojës për një Plan Biznesi afatmesëm (3 apo 5 vjeçar) tek IFN-të dhe mistria / ministritë përkatëse brenda Qeverisë së Kosovës. Kontaktet e vazhdueshme me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) dhe Bankën Evropiane për Investime (BEI) kanë rezultuar me konkretizim të kërkesës sonë për mbështetjen financiare të një Asistence Teknike që TRAINKOS-it do të i mundësonte përgatitjen e Plani të Biznesit paralel me zhvillimet tjera në sektorin hekurudhorë. Projektet e kësaj forme duhet të kenë "bekimin" e institucioneve relevante shtetërore për të mbështetur projektin në procedurat e mëtutjeshme në Western Balkan Investment Framework (WBIF, Kornizën e Investimeve në Ballkanin Jug – Perëndimorë) apo Instrument for Pre Accession (IPA, Instrumente të Para Anëtarësimit) fonde apo nga burimet vetanake të ndonjë IFN-je.

Kontaktet e rregullta me partnerët regjional kanë vazhduar, kjo kryesisht me ata të Republikës së Maqedonisë Veriore meqënse është kanali i vetëm ndërkombëtar në të cilin kemi qasje, dhe kanë qenë të përqendruara në krijimin e mundësive për të rritur transportin, po ashtu takime shume të rëndësishme në ngritjen e një bashkëpunimi kemi pasur edhe me Hekurudhat Kroate,me këtë rast jemi dakorduar për nënshkrimin e memorandumit të

bashkëpunimit ku synim kryesor është mbështetja në disa fusha me qëllim të ngritjes së kapaciteteve teknike dhe njerëzore.

Transporti i xehes, lëndës finale dhe thëngjillit për New Co Ferronikeli nga eksporti, importi dhe transporti minierë – punëtori në Drenas është realizuar në përqindje të madhe sipas planifikimeve të parapara me kontrat, po ashtu jemi dakorduar që bashkëpunimin tonë ta vazhdojm edhe gjatë vitit 2020.

Periudhën raportuese e karakterizon angazhimin tonë në forma indirekte me kompanitë që janë përzgjedhur dhe janë bartëse të realizimit të projektit "Rehabilitimi i Linjës së 10-të hekurudhore". Konkretisht seksioni Fushë Kosovë – Hani i Elezit do të jetë pjesa e parë për zbatim të projekteve të rehabilitimit / modernizimit të linjave ekzistuese të hekurudhave në territorin e Kosovës. Kontaktet tona kanë qenë paralele me 2 kompanitë e poshtëpërmendura:

GCF (Generale Construzione Ferroviarie S.p.A.), kompani fituese për zbatimin e projektit – Rehabilitimi i seksionit Fushë Kosovë – Hani i Elezit) dhe, Konzorciumit mes "Walter Beton GmbH" nga Gjermania me "Armos Precast S.A." nga Greqia dhe "CRON" nga Kosova - nën kontraktorë për prodhimin dhe furnizimin me traversa.

Me kompaninë GCF është biseduar për mundësi të ndryshme bashkëpunimi. Nga të gjitha kërkesat për bashkëpunim, mundësitë në të cilat është vepruar janë:

- Dhënia me qira e vagonëve në dispozicion të TRAINKOS- Më konkretisht është diskutuar dhënia e 3 vagonëve të tipit EAS dhe 3 të tipit E. Ne jemi duke e përcjellë planin e realizimit të projektit nëse e kemi parasysh koordinimin e këtyre planifikimeve me kërkesat për transport.
- Shqyrtimi i të gjitha mundësive për të përfituar nga mundësia e mirëmbajtjes dhe riparimit të mjeteve lëvizëse

## VII.2 Koordinimi i proceseve me ARH-në dhe Institucionet tjera

Periudha raportuese gjithashtu rezulton me angazhimin e vazhdueshëm në plotësimin e obligimeve në raport me Ministrinë e Infrastrukturës (MI), ARH-në, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZhE) dhe BERZh.

- Nga kërkesa e ARH-së dhe me bashkëpunim me ndërmarrjet tjera hekurudhore që veprojnë në Kosovë është përgatitur dhe plotësua lista me krahasim të legjislacionit dytësorë të zbatueshëm në Kosovë. Ky veprim është bërë me kërkesën e institucioneve përkatëse të BE-së me qëllim të mbështetjes paralele të të gjitha shteteve të Evropës Jug-Lindore;
- Procedurat rreth shqyrtimit dhe përgatitjes së Draft-rregullores mbi Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet në lidhje me nënsistemin 'Mjetet lëvizëse – lokomotivat dhe mjetet lëvizëse për udhëtarë STI LOC&PAS", drafti është finalizuar dhe është dërguar / përcjellë për hapa të mëtutjeshëm;
- Departamenti i Rregullimit të Tregut në kuadër të ARH-së duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ka, është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave

dhe udhëtarëve në periudha të rregullta mujore, si dhe është informuar në periudha të rregullta për proceset e diskutimit të Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022 me Ministrinë e Infrastrukturës;

- Enti Statistikor i Kosovës është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta raportuese;
- Gjatë periudhës raportuese është bërë koordinimin dhe zhvillimin e aktiviteteve në realizimin e projektit të aprovuar nga Kryemisitria – Muzeu i Bllacës. TRAINKOS-i ka mbështetë projektin me dhënjen dhe riaftësimin e tre vagonëve të udhëtarëve dhe një lokomotive;
- Përmes SEETO-s për procesin e monitorimit të Raportit të Progresit janë plotësuar kërkesat sipas pyetësorëve të kërkuar dhe në këtë periudhë kemi rishikuar avancimet në procesin e "masave të buta" për vitin 2019 që janë bazë për zbatim dhe kërkesa për zhvillim dhe avancim.
- Në bazë të kërkesës dhe veprimeve të ndërmarra është plotësuar dokumentacioni i nevojshëm dhe aplikimi për licencimin e katër makinistëve të rinj të kompanisë, procedurat janë kryer dhe licencat janë marrë me një afat shumë të shkurtër dhe të njëjtit kanë filluar punën.
- Me kërkesën e zyrtarëve të ARH-së dhe me mbështetjen përgjegjësve në TRAINKOS është realizuar inspektimi i mjeteve lëvizëse në disponim të TRAINKOS-it (NVR dhe VKM) dhe i gjendjes teknike të këtyre mjeteve lëvizëse.

## VII.3 Aktivitet e Marketingut

TRAINKOS SH.A.edhe gjatë këtij viti ka vazhduar me përmbushjen e obligimeve të dala nga Plani i Biznesit dhe Plani i Punës i Departamentit të Biznesit për monitorimin dhe vizitat e rregullta drejt klientëve të rregullt duke qenë afër tyre për shqyrtimin e çdo ankese apo kërkese që kanë në drejtim të kompanisë.

Po ashtu gjatë këtij viti janë zhvilluar kontakte dhe takime me klient potencial, me të cilët janë shqyrtuar mundësit e realizimit të transportit me hekurudhë.

Po ashtu nuk kanë munguar edhe aktivitet në rrjetet sociale, duke prezantuar shërbimet tona në transportin e mallrave dhe në transportin e udhëtarëve.

## VII.4 Raportimi i rregullt vjetor në Asociacionet tjera Hekurudhore

Raportimet e rregullta vjetore në CIT (International Rail Transport Committee) vazhdojnë të bëhen. Edhe viti 2019 rezulton me ngecje në aktivitetet për gjetjen e modalitete për të u anëtarësuar në asociacionet hekurudhore ndërkombëtare. Vlenë të përmendet se kjo ende po varet nga politikat shtetërore të cilat po zhvillohen dhe gatishmëria e institucioneve relevante qeveritare për të vepruar në këtë drejtim.

Projekti për mbështetjen e shteteve të Evropës Jug – Lindore i filluar në vitin 2018 e që do të krijoj mundësinë e planifikimeve afatmesme në planet afatmesme deri në vitin 2020 të këtyre shteteve sipas kërkesave që rrjedhin nga BE është në zbatim e sipër.
Ky projekt i rëndësishëm planifikohet të zgjatë një vit e gjysmë nëse e kemi parasysh kohën e nevojshme që planifikimet të inkorporohen në planet afatmesme dhe afatgjata për secilin shtet veç e veç. Zbatimi i projektit për TRAINKOS-in do të ishte mbështetje e duhur që së bashku me strategjitë tjera relevante për sektor të përgatitë Strategjinë afatmesme.

## VII.5 Sfidat kryesore gjatë vitit 2019 dhe veprimet për të ardhmen

Gjatë vitit 2019 si edhe viteve tjera, kompania ka vazhduar të ballafaqohet me shumë sfida si:

Mos respektimi i Ligjit të Hekurudhave të Kosovës Nr. 04 / L-076 për mbulimin e plotë të shpenzimeve për OSHP, nënshkrimi i Marrëveshjes për OShP 2018 – 2022 më 18.04.2018 kufizon linjat në minimum dhe sipas planifikimeve në KASh 2018 – 2021 nuk parashihet ndonjë zhvillim / reformë në këtë lloj të transportit publik ;

1. Mungesa e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor;
2. Proceset e shumta gjyqësore të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës;
3. Mos funksionimi i të gjitha linjave hekurudhore;
5. Vonesat në realizimin e projektit "Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore" si infrastrukturë bazë që bën lidhjen me pjesën tjetër të Evropës (infrastrukturë dhe reforma të sektorit hekurudhorë);
6. Mos zbatimi i bazës ligjore në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jo lojale;
7. Licencimi dhe futja në treg e operatorit hekurudhor privat, pa ndonjë analizë të mirëfilltë të tregut nga ana e institucioneve relevante;
8. Gjendja jo e mirë e mjeteve lëvizëse për shkak të vjetërisë së tyre dhe kostoja e lartë investuese;
9. Mungesa e një "Master Plani afatmesëm" për TRAINKOS-in;
10. Neglizhenca e institucioneve relevante të cilat veprojnë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në inkorporimin e operatorit shtetërorë në planifikimet strategjike për zhvillim industrial të vendit;
11. Mosha mesatare e lartë e personelit ekzekutiv;

Duke pasur parasysh që sfidat e lartcekura janë të natyrave të ndryshme dhe kërkojnë përkrahje edhe nga shumë institucione relevante, kompania është munduar në vazhdimësi që këto sfida/probleme t'i paraqes dhe të kërkojë zgjidhje/mbështetje, mirëpo marr parasysh karakterin e tyre ka qenë e pamundur arritja e rezultateve pozitive duke rezultuar edhe me mos përmirësimin e përgjithshëm të kompanisë.


Edhe në vazhdim ne mbetemi të përkushtuar dhe do të insistojmë që të gjitha këto probleme të trajtohen nga institucionet dhe faktorët tjerë relevant në mënyrë që të marrim zgjidhjen e duhur, me qëllim të zhvillimit të ndërmarrjes si aset shtetëror.

Për këto sfida të precizuara më lart përgjegjësit në kompaninë Hekurudhat e Kosovës - TRAINKOS Sh. A. sipas planifikimeve mbesin të përkushtuar në angazhimin maksimal në arritjen e realizimit të objektivave.

## VIII. STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH. A.

Operimi me trena në Hekurudhat e Kosovës - Trainkos SH. A. në vitin 2019 e ka filluar me një strukturë më të konsoliduar se në vitin 2018. Potenciali njerëzor i punonjësve në fillim të vitit 2019, ka qenë i sistemuar në bazë të përgatitjes së tyre dhe nevojave që ka kërkuar vetë procesi i punës. Shpërndarjes dhe sistemimit të tyre i ka paraprirë skema organizative e kompanisë e cila është ndërtuar në bazë të nevojave të punës të cilën do ta paraqesim në vijim:

**Skema organizative e HK-Trainkos Sh. A.**




Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK – Trainkos SH.A. është si vijon:

| Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK-Trainkos Sh.a. më 1 janar 2019 dhe më 31 dhjetor 2019 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Totali i të punësuarve** | **01.01.2019** | | **31.12.2019** | |
| | **236** | | **230** | |
| **Vlerat** | **Vlerat në numra** | | **Vlerat në përqindje** | |
| **Data** | **01.01.2019** | **31.12.2019** | **01.01.2019** | **31.12.2019** |
| **Mosha mesatare e punëtorëve** | **47.16** | **47.13** | **%** | **%** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Me marrëdhënie të rregullt pune** | **236** | **230** | **%** | **%** | Format e kontratave |
| **Me kontratë të paafatizuar** | **94** | **86** | **39.83%** | **38.19 %** | |
| **Me kontratë të afatizuar** | **142** | **144** | **60.16 %** | **61.80 %** | |
| **Meshkuj** | **211** | **203** | **89.40 %** | **88.41 %** | Gjinia |
| **Femra** | **25** | **27** | **10.59 %** | **11.58 %** | |
| **Serbë** | **2** | **2** | **0.84 %** | **0.85 %** | Nacionalitet |
| **Shqiptarë** | **234** | **228** | **99.15 %** | **99.57 %** | |
| **Me shkollim fillor** | **16** | **16** | **6.77 %** | **6.86 %** | Shkollimi |
| **Shkollim të mesëm** | **126** | **126** | **53.38 %** | **54.50 %** | |
| **Kualifikim profesional** | **24** | **22** | **10.16 %** | **9.87 %** | |
| **Me shkollim të lartë** | **4** | **2** | **1.69 %** | **1.28 %** | |
| **Me shkollim superior** | **66** | **64** | **27.96 %** | **27.46 %** | |
| **Zyrtarët e Lartë** | **4** | **5** | **1.69 %** | **2.14 %** | |
| **Kabineti i Kryeshefit Ekzekutiv** | **3** | **3** | **1.28 %** | **1.27 %** | |
| **Departamenti i Transportit të Mallrave** | **52** | **51** | **22.03 %** | **22.74 %** | |
| **Departamenti i Transportit të Udhëtarëve** | **63** | **64** | **26.69 %** | **27.46 %** | Përshkrimi i Departamenteve |
| **Departamenti i Administratës** | **42** | **41** | **17.79 %** | **17.59 %** | |
| **Departamenti i Financave** | **9** | **10** | **3.81 %** | **4.29 %** | |
| **Departamenti i Zhvillimit të Biznesit** | **7** | **6** | **2.96 %** | **2.57 %** | |
| **Departamenti i Prokurimit** | **4** | **3** | **1.69 %** | **1.28 %** | |
| **Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit** | **20** | **19** | **8.47 %** | **8.58 %** | |
| **Zyra për Marrëdhënie me Publikun** | **2** | **2** | **0.84 %** | **0.84 %** | |
| **Zyra e Mirëmbajtjes së Lokomotivave dhe Trenave Motorik** | **27** | **23** | **11.44 %** | **9.87 %** | |
| **Zyra Ligjore** | **3** | **3** | **1.27 %** | **1.28 %** | |

**Tabela 8.1**

**Sqarim:** *Gjatë periudhës janar - dhjetor 2019 kemi pasur 7 punësime, 9 pensionime,4 ndërprerje të një anshme të marrëdhënies së punës. Gjatë vitit 2019, në këtë tabelë nuk janë përfshirë as anëtarët e Bordit të Drejtorëve.*

# IX. ZYRA LIGJORE

## IX.1 Kontestet gjygjësore

Gjatë periudhës kohore janar - dhjetor 2019, nga zyra ligjore e ndërmarrjes janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për përfaqësim sa më të mirë në çështjet ligjore pranë të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Gjatë periudhës janar - dhjetor 2019 pranë Gjykatave Themelore i kemi mbajtur **30** (**tredhjetë**) seanca gjyqësore për proceset në të cilat kemi qenë palë në procedurë qoftë në cilësinë e të padituresë apo të paditëses.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2019, ndërmarrja jonë në procedurë ka pasur **67 (gjashtëdhjetë e shtatë)** lëndë, prej tyre **8 (tetë)** janë pranuar gjatë kësaj periudhe, ndërsa **13 (trembëdhjetë)** lëndë kanë përfunduar me vendime të formës së prerë.

Prej **13 (trembëdhjetë)** lëndëve të përfunduara gjatë periudhës kohore janar - dhjetor 2019 me vendime të formës së prerë ndërmarrja jonë është obliguar që të paguajë rreth **104,249.06** € në emër të kompensimeve të dëmeve, shpenzimeve gjyqësore dhe permbarimore.

Përkundër faktit se Ndërmarrja në vazhdimësi është ballafaquar me probleme të natyrave të ndryshme rreth ruajtjes së interesave të saj e sidomos sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me kontestet nga kompensimi i dëmeve në të gjitha rastet e aksidenteve të komunikacionit hekurudhor prej të cilave konteste një numër i konsiderueshëm janë trashëguar nga ish - Hekurudhat e Kosovës Sh.A., në një mënyre ndërmarrja jonë ka arritur që një situatë të tillë ta menaxhojë me sukses.

Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh. A. në vitin 2019, është ballafaquar me **67 (gjashtëdhjetë e shtatë)** konteste gjyqësore. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve të hapura dhe kategorizimi i tyre gjatë vitit 2019:

| Nr. | LLOJET E KONTESTEVE | ////////// |
|---|---|---|
| 1. | **Kontestet e marrëdhënies së punës** | **15** |
| 2. | **Kontestet për kompensim të dëmit** | **26** |
| 3. | **Kontestet për pagimin e borxhit** | **4** |
| 4. | **Kontest nga Konflikti Administrativ** | **1** |
| 5. | **Lëndë në procedurë përmbarimore** | **21** |
| 6. | **Totali** | **67** |

**Tabela 9.1**

Pra siç shihet në tabelë, **15 (pesëmbëdhjetë)** lëndë janë nga kontestet e punës, **26 (njëzet e gjashtë)** lëndë janë nga kontestet e kompensimit të dëmit, **4 (katër)** lëndë janë nga kontestet për kthim të borxhit, **1 (një)** lëndë nga kontesti i Konfliktit Administrativ dhe **21 (njëzet e një)** lëndë nga procedura përmbarimore.

Në rast se ndodh që të gjitha këto konteste të përfundohen me vendime të formës së prerë atëherë HK-Trainkos Sh. A. rrezikohet që të paguajë në emër të kompensimeve shumën **1,818,610.00 €**, ku duke pas parasysh gjendjen në të cilën gjendet ndërmarrja do të jetë e pa përballueshme.

Vlen të përmendet se rreziku kryesor për HK-Trainkos Sh.A. vjen nga lënda me numër P.nr.173/17, në të cilin rast HK - Infrakos Sh.A ka parashtruar propozim për përmbarim pranë përmbaruesit privat ku ka kërkuar që HK-Trainkos Sh.A ti përmbarohen në mënyrë të dhunshme shuma në vlerë prej **827,259.27 €.**

## IX.2 Rreziqet nga kontestet gjygjësore për vitin 2020

Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A në vitin 2020 do të ballafaqhet me **58 (pesëdhjetë e tetë)** konteste gjyqësore të cilat kanë mbetur në procedurë nga vitet paraprake. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve të hapura dhe kategorizimi i tyre me të cilat do të ballafaqohemi për të gjatë vitit 2020:

| Nr. | LLOJET E KONTESTEVE | ////////// |
|---|---|---|
| 1. | **Kontestet e marrëdhënies së punës** | **15** |
| 2. | **Kontestet për kompensim të dëmit** | **24** |
| 3. | **Kontestet për pagimin e borxhit** | **4** |
| 4. | **Kontest nga Konflikti Administrativ** | **1** |
| 5. | **Lëndë në procedurë përmbarimore** | **14** |
| 6. | **Totali** | **58** |

Andaj duke pas parasysh gjendjen në të cilën gjendet ndërmarrja jonë, kontestet gjyqësore mbesin si një ndër rreziqet më të mëdha për arsye se janë në numër shumë të madh si dhe me vlera të larta financiare. Në rast të humbjes të ndonjë kontesti kompanisë do ti thellohet kriza financiare edhe më tepër.

## X. TRANSAKSIONET E REALIZUARA

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës:

| Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse | |
|---|---|
| Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2019 | 231.13 |
| Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – dhjetor 2019 | 1,872,443.35 |
| Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2019 | 1,872,368.62 |
| Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2019 | 305.67 |

**Tabela 10.1**

| Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës | |
|---|---|
| Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2019 | 54,554.75 |
| Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – dhjetor 2019 | 193,102.59 |
| Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2019 | 246,191.67 |
| Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2019 | 1,465.67 |

**Tabela 10.2**

# XI. PËRFUNDIM

TRAINKOS Sh.A. edhe në vitin 2019 ka vazhduar të funksionoj sipas planifikimeve të prezantuar dhe aprovuara me Planin e Biznesit 2019. Pengesat për zhvillimin e biznesit vazhdojnë të ndikohen nga faktorë të ndryshëm. Rrethanat e krijuara nga sfidat që përcjellin kompaninë që nga fillimi kanë ndikuar mjaft shumë në operimin e rregullt në ofrimin e shërbimit në transportin e mallrave, transportin e udhëtarëve, mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse apo edhe fushëveprimet tjera të cilat janë vitale për një funksionim normal të kompanisë.

Ministritë përkatëse: MI, MZhE dhe MF mbesin faktorë të jashtëm domethënës në zhvillimin e veprimtarisë dhe proceseve të ndodhura gjatë viteve pas procesit të ndarjes. Politikat e aprovuara me Strategjitë përkatëse për sektorin hekurudhorë nuk janë zbatuar sipas planit të veprimit. Me vonesat e fillimit të punëve për modernizimin e linjave hekurudhore vazhdon gjendjen e qëndrimit në vend edhe për operatorin publik - TRAINKOS-in. Fillimi i zbatimit të projektit për modernizimin e sektorit Fushë Kosovë – Hani i Elezit rrit shpresat që Qeveria (aksionari 100% i TRAINKOS-it) të filloj të koordinojë veprimet edhe me zhvillimin e Operatorit hekurudhorë gjithashtu.

Përgatitja dhe aprovimi i "Planit Afatmesëm Investiv 2020 – 2024" nga TRAINKOS-i me përfshirjen e proceseve që po ndodhin në sektorin hekurudhorë paraqet një fillim të mbarë nëse e kemi parasysh se është dokumenti i parë strategjik i kompanisë për një periudhë pesë vjeçare. TRAINKOS-i do të përgatitë një Plan të Veprimit për zbatimin dhe përcjelljen e progresit të "Planit Afatmesëm Investiv 2020 – 2024".

TRAINKOS-i funksionon sipas strukturës organizative të aprovuar nga instancat përgjegjëse në bazë të gjendjes aktuale të transportit të mallrave dhe udhëtarëve por me zhvillimet që parashihen do të përkujdeset që të ketë staf profesional që mundëson krijimi i kushteve për siguri në punë dhe plotësimi i të gjitha kushteve tjera për transport të sigurt.

Procesi i avancimeve në sistemin hekurudhorë me planifikimet strategjike për kontinentin nga BE-ja, funksionalizimi i tërë Rrjeti Bazik Hekurudhorë të Evropës dhe kërkesat që vijnë nga nevoja për reformim të këtij sistemi në Evropën Jug Lindore kërkojnë përgatitje adekuate për kompaninë. Kjo nëse e kemi parasysh nevojën e planifikimeve të furnizimit me mjete lëvizëse adekuate sipas trendit të modernizimit të linjave hekurudhore dhe rritjes së vëllimit të transporti në dhe mbrenda vendit. Pastaj është dhe do të jetë sfiduese plotësimi i kritereve të Interoperabilitetit përmes TSI dhe plotësimi i kritereve / kërkesave që vijnë përmes Planit të Veprimit për Mekanizmin Stabilizim Asociim (PVMSA) dhe kërkesat tjera që TRAINKOS -i duhet me i plotësua si pjesë përbërëse e sistemit hekurudhorë të Republikës së Kosovës.

Veprim urgjent nevojitet kur kemi të bëjmë me Licencimin e punëtorive (në posedim të TRAINKOS-it), tani sipas Rregullores së lëshuar nga ARH-ja (Rregullorja Nr.01/2019 për verifikimin e entiteteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave, datë 28.06.2019) që plotëson standardet e kërkuara nga ERA. Kjo vjen sipas kërkesës që vjen nga

BE-ja përmes SEETO-s me mekanizmin e PVPE-së e që ka të bëjë me përpilimin dhe futjen në funksion të legjislacionit dytësorë për sektorin hekurudhorë, konkretisht licencimin për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore. Disa shtete në regjion kanë vepruar me shpejtësi dhe janë Licencuar, e për këtë duhet të fillohet me përcaktimin dhe zbatimin e detyrave që rrjedhin për këtë proces mbrenda kompanisë (stafi, punëtoritë, pajisjet dhe të tjera) në të gjitha punëtoritë e TRAINKOS-it.

Përkushtimi i përhershëm mbetet në angazhimet tona të përditshme për zhvillimin e mëtutjeshëm të ndërmarrjes në ofrimin sa më të mirë të shërbimeve tona për klientët tanë.

**Fushë Kosovë,**
**28.02.2020**

**Kryeshef Ekzekutiv**
**Gelor Shala**